# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-413702**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dyfishohen regjistrimet në FSHN, rritet interesi i i të rinjve për degët në Fakultetin e Shkencave të Natyrës – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/dyfishohen-regjistrimet-ne-fshn-rritet-interesi-i-i-te-rinjve-per-deget-ne-fakultetin-e-shkencave-te-natyres/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 17:52:41 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 2 shtator 2026, 13:44:26 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b784d71b78f4597a0033eb6d45494ab2a540ef3fbe935110c6085ee29de6e8ab` |
| TEKSTI | `7debdc7841f100a522210e10994b5f23795560f8cd524e2d9ff4195c97890da4` |
| PAMJA | `a1f955c81a917c5e911589c6b96906488edd6f9bd52c5f8b2799836bbc6ae690` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4c8068ff05a17187282e0ba230a49c8d02a9d0e5357dc8abd118ddefd5d4df7b` |
| E MËPARSHMJA | `70422562b4ad15ff20e97077a8fbad2b013ca1bf0de67b075ce57d6a7b95994e` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4c8068ff05a17187282e0ba230a49c8d02a9d0e5357dc8abd118ddefd5d4df7b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mes dhjetë preferencave të renditura në U-Albania, maturantja Xhoi Veliaj zgjodhi një prej programeve që lidhen drejtpërdrejt me teknologjinë. “Data Science dhe Inxhinieri Informatike”, thotë se iu përshtat më shumë, pasi u njoh me mundësitë në tregun e punës.

“***Kam zgjedhur Data Science dhe Inxhinieri Informatike. Mendoj se është një mundësi shumë e mirë, pasi tregu i punës po orientohet drejt inteligjencës artificiale. Mendoj se ka shumë mundësi edhe brenda Shqipërisë, por edhe jashtë. Nëse më ecën në Shqipëri, nuk kam dëshirë të largohem”, tha Xhoi Veliaj, maturante.***

Në fazën e deritanishme të regjistrimeve, Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka shënuar një rritje të interesit, me rreth dyfishin e regjistrimeve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

“***Në këtë fazë kemi rreth dyfishin e regjistrimeve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, madje edhe pak më shumë se në vitet e tjera. Ajo që vlen të theksohet është edhe cilësia e maturantëve që kanë zgjedhur programet tona. Bëhet fjalë për maturantë me rezultate shumë të mira”, tha Eglantina Kalluçi, dekane e FSHN-së.***

Më shumë regjistrime kanë numëruar edhe degët prioritare.

***“Kjo tendencë vihet re në të gjitha programet, duke nisur nga degët prioritare si Matematika, Biologjia, Kimia dhe Fizika, por edhe në programet më të kërkuara aktualisht, si Informatika, Data***

5 “Dhembalia e pjekurisë mund të shkaktojë tumor”, kirurgu oral: Kur…

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

***Science, Teknologjia e Informacionit dhe Bioteknologjia", shtoi Kalluçi.***

Paralelisht, fakulteti ka sjellë bashkëpunimin me bizneset, për t'i lidhur studentët me tregun e punës që gjatë studimeve,  ndërsa për këtë vit të ri akademik, bashkëpunimi është zgjeruar.

"***Vitin e kaluar kishim vetëm një program që mbështetej nga industria, ndërsa këtë vit kemi dy apo tre programe të tilla. Për shembull, Inxhinieria Kimike, Inxhinieria dhe Kimia e Ushqimeve, si edhe Kimia Farmaceutike. Janë programe studimi që lidhen drejtpërdrejt me industrinë dhe tashmë vihet re edhe një orientim më i madh i maturantëve drejt këtyre profileve", tha ajo.***

Sipas dekanes Kalluçi, përditësimi i kurrikulave, mundësitë e shkëmbimeve jashtë vendit dhe lidhja më e fortë me punësimin kanë ndikuar në ndryshimin e trendit, duke rikthyer interesin e maturantëve edhe te degët prioritare.

#FSHN #Maturantet

**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh




SOCIALE

**Gjykata e Vlorës i jep fund bojkotit: Nga e...**

Taulant Halili · 12 Sht



SOCIALE

**Stuhi shiu në Elbasan, uji vërshon në rrugë**

Taulant Halili · 12 Sht



SOCIALE

**Ulje temperaturash dhe reshje shiu,...**

Taulant Halili · 11 Sht



© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.